



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 388, datë 13.12.2021

PËR EMËRIMIN SI PROKUROR NË PROKURORINË E POSAÇME KUNDËR
KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, në nenet 4 dhe 12 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", në nenet 48 pika 1 dhe 61 pika 2/3 dhe 163 pika 2 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2 dhe 189 pika 1 germa "a" të Ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në nenin 3 pika 11 të Rregullores "Mbi Kriteret dhe Procedurën për Ngritjen në Detyrë të Prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të emërojë si prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar z. Alfred Shehu për një mandat 9 (nëntë) vjeçar pa të drejtë riemërimi.
2. Të njoftohen për këtë vendim Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Alfred Shehu, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë .
3. Ky vendim hyn në fuqi në dt. 01.01.2022 dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

